




Në bazë të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për procedurat e themelimit, organizimit dhe kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komunë, bazuar në Vendimin 01.Nr.109/2023 të datës 31.7.2023 për themelimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuar, Kuvendi i Komunës së Rahovecit shpall:



## KONKURS PUBLIK

### Për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

Komiteti Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara do të përbehet nga shtatë (7) anëtarë. Mandati i anëtarëve të Komitetit është katër (4) vjeçar, nga themelimi i Komitetit. Anëtarët e zgjedhur nuk mund të shërbejnë më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

### Kompetencat:

- Ofrimi i propozimeve për rregullore të ndryshme dhe akte tjera të brendshme për fushën e aftësisë së kufizuar.
- Koordinimi i politikave, programeve dhe proceseve në lidhje me çështjen e aftësive të kufizuara dhe zhvillimi i hulumtime në fushën përkatëse.
- Analizojnë çështje që kanë të bëjnë me zhvillimin e personave me aftësi të kufizuar dhe të drejtat e tyre.
- Definimi i prioriteteve dhe masave të nevojshme që duhet të ndërmerren nga kuvendi i komunës dhe shoqëria civile për përmirësimin e situatës së tanishme në lidhje me personat me aftësi të kufizuar në secilin sektor.
- Hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga kryetari i komunës, komitetet e përhershme apo edhe kuvendi i komunës në fushën e personave me aftësi të kufizuar.

- Paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës
- Përcjell dhe kujdeset për procedurat nëpër të cilat duhet të kalojnë dokumentet nga sfera e personave me aftësi të kufizuara, të cilat në pajtim me dispozitat ligjore miratohen në Kuvendin e Komunës.
- Kryen edhe punë të tjera të cilat dalin nga fusha e personave me aftësi të kufizuar.

### **Kushtet:**

- Të jetë banor i Komunës së Rahovecit;
- Diplomë universitare në lëminë përkatëse ose të ngjashme (e dëshirueshme);
- Të jetë njohës i mirë i fushës së personave me aftësi të kufizuar;
- Kopja e letërnjoftimit.

Aplikacionet, që përbëhen nga kërkesa, CV-në dhe dëshmitë për përvojën tuaj në lëmitë e theksuara më lartë, duhet t'i dorëzoni në Zyrën e pranimit të KK-së, duke e cekur për Sekretarinë e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Përzgjedhja e anëtarëve të Komitetit Konsultativ bëhet nga Paneli Përzgjedhës i formuara me vendimin 01.Nr.109/2023 të datës 31.7.2023 nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes.**

Aplikacionet e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit, respektivisht pas datës 14 shtator 2023, nuk do të merren në shqyrtim.

**Vërejtje:** Dokumentacioni i bashkëngjitur i aplikacionit duhet të jetë i fotokopjuar.

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni Sekretarinë e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

